

ÇËSHËTJA E
KOMPLEKSIT TË TREPÇËS NË
KONTEKSTIN E 'FINALES SË MADHE'
EVENTUALE NDËRMJET
KOSOVËS DHE SERBISË





Sheshi Nënë Terezë, Hyrja. I · 59A · Nr. 10
Prishtinë, 10000
Republika e Kosovës
T/F: +383 38 746 206
E-mail: ridea.institute@gmail.com
Website: www.ridea-ks.org

STUDIM

MBI

ÇËSHTJEN E KOMPLEKSIT TË TREPÇËS NË KONTEKSTIN E 'FINALES SË MADHE' EVENTUALE NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË

Nëntor 2019

STUDIM

MBI

ÇËSH TJEN E KOMPLEKSIT TË TREPÇËS NË KONTEKSTIN E 'FINALES SË MADHE' EVENTUALE NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË

Ky studim u mbështet nga:



Norwegian Embassy

Deklaratë mohimi: Pikëpamjet dhe analiza në këtë raport janë vetëm të RIDEA-s dhe nuk pasqyrojnë pikëpamjet e donatorit.

Autor: Instituti Kërkimor për Çështje Evropiane dhe të Zhvillimit (RIDEA)

Nëntor 2019

Përmbajtja

Shkurtesat	i
Hyrje	1
Trepça gjatë periudhës së kontrollit nga Serbia (mars 1989-qershor 1990)	7
Trepça nën UNMIK dhe Kosovën e Pavarur	12
Trepça sipas Ligjit të ri	14
Konkluzionet dhe Rekomandimet: Çështjet kryesore për Kosovën	17
Shtojca 1	22
Shtojca 2	23
Shtojca 3	24
Shtojca 4	25
Shtojca 5	26
Shtojca 6	27

Shkurtesat

AKM	Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
ARBK	Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë
NJB	Njësi Biznesi
NSH	Ndërmarrjet Shoqërore
OKPA	Organizata Komplekse e Punës së Asociuar
OTPA	Organizata Themelore e Punës së Asociuar
PPP	Partneriteti Publiko Privat
RSFJ	Republika Socialiste Federale e Jugosllavisë
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

Hyrje

1. Është e rëndësishme të theksohet statusi ligjor i ndërmarrjeve në ish Jugosllavi dhe gjithashtu rëndësia e marrëdhënieve ndërmjet njësive kushtetuese e përbërëse të Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë (RSFJ). Në bazë të Kushtetutës së vitit 1974, Jugosllavia ishte një federatë e përbërë nga tetë njësi të barabarta (gjashtë Republika dhe dy Krahina Autonome), secila prej tyre përgjegjëse dhe nën kontrollin e ekonomisë dhe politikës së tyre, me institucionet e veta të qeverisë autonome (kuvende, qeveri, gjykata, etj.). Në të vërtetë, të dy provincat/krahinat duhej të bienin dakord për ndryshimet në ligjet Serbe që mund të afektonin ato. Çdo ndryshim në aranzhimet kushtetuese në Serbi duhej të miratohej nga Asambleja e dy krahinave/provincave, të Kosovës dhe Vojvodinës.
2. Pronësia e ndërmarrjeve në ish Jugosllavi u bazua në konceptin e "pronësisë shoqërore". Kjo nënkuptonte që ndërmarrjet ishin në pronësi të shoqërisë, por u ishin besuar punonjësve të tyre për t'i menaxhuar ato, për t'i mirëmbajtur ato dhe për të përfituar prej tyre. Kushtetuta e vitit 1974 paraqiti nocionin e 'Organizatës Themelore të Punës së Asociuar (OTPA, ang: Basic Organisation of Associated Labour, BOAL)' (një kompani ose nën-njësi e një kompanie e cila mund të identifikohet si një njësi e veçantë teknike/ekonomike) si njësi vendim-marrëse vendimtare për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ndërmarrjen ose nën-njësitë e tyre. Kompanitë e mëdha u quajtën 'Organizata Komplekse të Punës së Asociuar/lidhur (OKPA, ang: Complex Organisation of Associated Labour, COAL); Këto organizata mblidhnin së bashku përfaqësuesit e të gjithë OTPA-ve për të bashkërenduar vendimet e tyre veçanërisht në aspektin e planeve aktuale dhe strategjike të prodhimit dhe investimit (pa ndërhyrë në procesin e vendimmarrjes së njësive individuale). Punonjësit ushtronin të drejtat e tyre vetanake përmes organeve të vetë-menaxhimit në ndërmarrjet e tyre (Kuvendi, Këshilli i Punëtorëve dhe Këshilli Drejtues/Menaxhues). Shoqëria, në formën e qeverisë komunale, provinciale ose republikane, ishte përgjegjëse për të siguruar që asetet të mirëmenaxhohen, të mirëmbahen dhe të avancohen (prandaj, ekzistonin rregulla se si të ndahen të ardhurat neto të një ndërmarrjeje midis pagave të punonjësve dhe

investimeve në kompani). Pra punonjësit kishin të drejta të plota për të vendosur mbi punët e kompanisë së tyre.

3. Në fund të viteve 1980, Ligji mbi Kapitalin Social 1989/1990 (i njohur më mirë si 'Ligji Marković') u mundësoi punonjësve të vendosin për privatizimin e plotë ose të pjesshëm të kompanisë së tyre me disa aksione që u shkojnë punonjësve (me çmime të zbritura në varësi të kohëzgjatjes të shërbimit të tyre) dhe të tjerat në fondet e pensioneve ose investitorët e jashtëm. Por ishin punonjësit që kishin të drejtën e marrjes së vendimeve të tilla - dhe jo qeveria (krahinore/provinciale ose Republika). Pra, për çdo kompani, duke përfshirë Trepçën, çdo vendim mbi ristrukturimin apo transferimin e pronësisë mund të bëhej vetëm nga punonjësit e tij dhe nga organet e vetëqeverisjes.
4. Trepça ishte ndërmarrja më e madhe shoqërore në Kosovë dhe një eksportues i madh dhe burim fitimi i valutës së huaj në Jugosllavi. Ishte një kompleks i madh industrial, metalurgjik dhe kimik i bazuar në Kosovë (edhe pse kishte disa pasuri në pjesë të tjera të Jugosllavisë). Në kulmin e saj në fillim të viteve 1980, Trepça punësonte rreth 22,000 punonjës, edhe pse niveli i punësimit u zvogëlua gradualisht gjatë viteve 1980 dhe më vonë. Deri në fund të viteve 1980, OKPA Trepça përbëhej nga 21 OTPA (secila minierë, çdo njësi e flotacioneve, çdo njësi metalurgjike, çdo fabrikë, etj. ishte një OTPA). Çdo OTPA ishte përgjegjëse për vendimet e veta dhe kishte bordin e vet dhe menaxherin e përgjithshëm.
5. Me gjithë rëndësinë e saj për Kosovën dhe ekonominë Jugosllave, Trepça ishte në përgjithësi një ndërmarrje që operonte me humbje gjatë periudhës Jugosllave dhe varej nga subvencionet nga Qeveria, nga kreditë nga bankat dhe nga kredia nga Fondi Federal për Zhvillimin e Përsheptuar të Republikrave më pak të Zhvilluara dhe Krahinave.¹
6. Në mars të vitit 1989, Qeveria Serbe hoqi autonominë e Kosovës në kundërshtim me kushtetutën jugosllave duke improvizuar një votim në Kuvendin e Kosovës që të

¹ Palairt, M. (2003), 'Trepca, 1965-2000, fq.5.' Në dispozicion në: https://www.esiweb.org/pdf/esi_document_id_62.pdf [Qasur më 12 tetor, 2019].

miratonte ndryshimet kushtetuese në Republikën e Serbisë, të cilat e përforcuan fuqinë e Serbisë në dy krahinat/provincat autonome. Fakti që Gjykata Kushtetuese e Kosovës e anuloi këtë vendim në nëntor 1989, u injorua nga Qeveria e Serbisë.

7. Përmes një sërë ligjesh dhe dekretesh të miratuara nga Kuvendi i Serbisë në vitin 1989 dhe 1990, Serbia mori kontrollin e drejtpërdrejtë të jetës politike dhe ekonomike në Kosovë, duke shfuqizuar Kuvendin e Kosovës, duke emëruar menaxherë për ndërmarrjet e Kosovës në kundërshtim me rregullat e vetë-menaxhimit dhe duke përjashtuar nga puna rreth 140,000 punonjës shqiptarë të këtyre ndërmarrjeve (duke përfshirë një numër të madh në Trepçë).
8. Shumica e punonjësve shqiptarë të Trepçës u përjashtuan/larguan nga puna nga menaxhmenti i emëruar nga Qeveria Serbe (një veprim i paligjshëm sipas ligjeve Jugosllave) dhe riorganizimi i Trepçës u zhvillua pa pjesëmarrjen dhe pajtimin e mijëra punonjësve të ligjshëm (edhe kjo ishte e jashtëligjshme me ligjet Jugosllave). Dekretet dhe ligjet e miratuara pas heqjes së autonomisë së Kosovës ishin në kundërshtim me kushtetutën e Jugosllavisë dhe, si të tilla, të paligjshme. Ato ishin gjithashtu diskriminuese pasi që ishin thellësisht të orientuara kundër nacionalitetit shqiptar. Autoritetet serbe ose menaxherët e tyre të emëruar shkelën të drejtat e vetë-qeverisjes të punonjësve dhe nuk kishin fuqinë ligjore për të riorganizuar ndërmarrjet kosovare ose për të ndryshuar strukturën e tyre të pronësisë.
9. Një nga vendimet e para të UNMIK-ut ishte të deklaronte e shpaloste të ashtuquajturat "ligje të zbatueshme" në Kosovë. Të gjitha ligjet Jugosllave u konsideruan si të zbatueshme në Kosovë përveç atyre që ishin diskriminuese ndaj shtetasve shqiptarë të Kosovës. Heqja e autonomisë, kontrolli i drejtpërdrejtë i ndërmarrjeve, shkarkimi i punonjësve shqiptarë dhe vendimet pasuese për të ndryshuar pronësinë e kompanisë ishin shembujt kryesorë të ligjeve diskriminuese dhe u konsideruan si të pavlefshme.
10. Pas ngjarjeve të viteve 1990 dhe luftës së 1998-99, shumica e NSH-së Trepça ka qenë ose jo në funksion ose duke punuar dukshëm nën kapacitetin e saj. Aktualisht Trepça përbëhet nga minierat dhe flotacionet (këto dy aktivitete janë të lidhura

ngushtë meqë plumbi i zinkut duhet të transformohet në koncentratin e plumbit ose të zinkut duke kaluar nëpër procesin e flotimit), si dhe nga nën-njësi të tjera si: metalurgjike, kimike dhe nën-njësi të tjera që ofrojnë shërbime. Këto njësi e nën-njësi janë përshkruar në paragrafët e mëposhtëm. Në përgjithësi, njësitë e Trepçës ndodhen në tri zona: të Trepçës Veriore, Qendrore dhe Jugore, ku Trepça Veriore është nën kontrollin e punonjësve serbë dhe në një masë të madhe është e ndarë nga pjesa tjetër e njësisve të Trepçës. Vendndodhja e minierave (aktive dhe joaktive), njësitë e flotacioneve dhe shkrirjes prezantohen në hartën e dhënë në Shtojcën 1.

11. Minierat dhe Flotacionet: Rripi mineral i Trepçës përbëhet kryesisht nga xeherore të zinkut dhe plumbit me sasi më të vogël argjendi, ari dhe metale të tjera të çmuara dhe të rënda. Minierat aktive dhe njësitë e tyre të flotacioneve janë:

- Miniera e Stantërgut, e vendosur rreth 9 km në verilindje të Mitrovicës, që punon me njësinë e flotacionit Tuneli i Parë.
- Miniera e Artanës dhe njësia e flotacionit në Kishnicë (ka disa miniera në këtë zonë që përdoren për të furnizuar njësinë e flotacionit të Kishnicës, por këto janë të gjitha jashtë funksionale (të përmytura).
- Miniera e Belo Bërdos, e vendosur rreth 16 km në verilindje të Leposaviqit dhe mu në kufirin me Serbinë; 77% e depozitave të kësaj miniere ndodhen në territorin e Serbisë dhe 23% në territorin e Kosovës. Disa nga objektet siç janë ventilimi dhe pajisjet e ujit gjenden në anën serbe.
- Miniera e Cërnac, që ndodhet rreth 10 km në jugperëndim të Leposaviqit, që gjendet gjithashtu në kufirin me Serbinë; 58% e depozitave të kësaj miniere ndodhen në territorin e Serbisë dhe 42% në territorin e Kosovës. Disa nga objektet siç janë ventilimi dhe pajisjet e ujit gjenden në anën serbe.
- Minierat e Belo Bërdos dhe Cërnac-it që punojnë me njësitë e flotacioneve në Leposaviq.

12. Aktivitetet metalurgjike përbëhen nga:

- Shkritore dhe rafineritë që prodhojnë plumb dhe argjend në Zveçan. Shkrirja e plumbit u mbyll nga UNMIK-u dhe KFOR-i në vitin 2000 për shkak të niveleve të rrezikshme të ndotjes. Aktualisht, ekziston një riciklim

i vogël i baterive (nxjerrja e plumbit nga bateritë e përdorura) që ndodhin në uzinën e Zveçanit.

- Impianti elektrolitik i zinkut në Parkun Industrial të Mitrovicës. Metalurgjia e zinkut u mbyll për shkak të një zjarri, po ashtu në vitin 2000. Në vitet e fundit është punuar në rindërtimin e një furre me oksid zinku (ZnO) në Mitrovicë, por kjo ende nuk është përfunduar.

13. Aktivitetet kimike dhe të tjera prodhuese përbëhen nga:

- Industria kimike, e cila prodhonte kryesisht Acid Sulfurik, gjendet në Parkun Industrial të Mitrovicës, tani prodhon vetëm një sasi të vogël sulfati alumini për impiantet e trajtimit të ujit në të gjithë Kosovën, duke punësuar rreth 40 punëtorë.
- Fabrika e Procesimit të Pajisjeve (dhe Traktorëve), Mitrovicë. Kjo kompani tani është e përfshirë vetëm në mirëmbajtjen e pajisjeve në Trepçë, me 25 punonjës. Është në gjendje të prodhojë rimorkio traktori nëse ka ndonjë kërkesë.
- Fabrika e Baterive, gjithashtu e vendosur në Parkun Industrial të Mitrovicës, tani nuk është funksionale (nuk operon).
- Trepça Energji, Zveçan, përdoret për të prodhuar energji elektrike nga termocentralet dhe për ta shpërndarë atë në minierat dhe njësitë e flotacioneve, por tani nuk është funksionale.

14. Nën-njësitë e prodhimit të shërbimit të Trepçës janë:

- Instituti Trepça, Zveçan, ishte një institut kërkimor i angazhuar në punën shkencore në lidhje me aktivitetet e Trepçës. Tani është përfshirë në monitorimin e niveleve të ndotjes së ujit, ajrit dhe tokës për njësitë nën menaxhimin e Zveçanit (e ashtuquajtura Trepça e Veriut).
- Trepça Trans, Zveçan, ishte përgjegjës për transportimin e mallrave në të gjithë Trepçën. Aktualisht, ajo ofron shërbime të transportit vetëm për njësitë e drejtuara nga Menaxhmenti në Zveçan.
- 'Standardi' i Trepçës, Mitrovicë, ishte përgjegjës për përgatitjen e ushqimit për të punësuarit, si dhe aktivitete rekreative, kulturore dhe

edukative për të gjithë Trepçën. Tani ajo ofron këto shërbime vetëm për njësitë nën menaxhimin në Zveçan.

- Laboratori i Trepçës, Zveçan, ishte përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe sasisë së mallrave të prodhuara dhe dhënien e certifikatave për të gjithë Trepçën. Tani ajo ofron këto shërbime vetëm për njësitë e drejtuara nga menaxhmenti në Zveçan.
- Qendra e Kontabilitetit në Mitrovicë, siguron shërbime të kontabilitetit për kompaninë. Tani nuk është funksionale.
- Trepça 'Commerce', Mitrovicë, ishte e angazhuar në shitje dhe furnizime për të gjithë Trepçën. Tani nuk është funksionale.
- Mjekësia Profesionale, Zveçan, një njësi e vogël mjekësore që ofron trajtime mjekësore për punonjësit. Tani nuk është funksionale.
- Banka Trepça, Zveçan, ofronte shërbime bankare për Trepçën. Tani nuk është funksionale.
- Mbrojtja e Pronës, Zveçan, ishte përgjegjës për mbrojtjen e pasurive të Trepçës dhe sigurinë e të gjitha fabrikave dhe aseteve. Tani nuk funksionon dhe siguria ofrohet nga dy pjesët e veçanta të Trepçës.

15. Përveç nën-njësive të renditura në paragrafin 11-14 më lart, NPSH Trepça gjithashtu përfshinte nën-njësitë e mëposhtme të cilat ishin vënë nën moratoriumin e DHPGJS-së. Por në janar 2011, DHPGJS i lëshoi këto ndërmarrje jo-thelbësore nga moratoriumi dhe i ktheu ato në AKP për privatizim apo likuidim. Disa nga këto kompani tashmë janë privatizuar ndërsa të tjerët ende janë nën administrimin e AKP-së ose në procesin e privatizimit.

- Fabrika për prodhimin e municioneve për gjueti, Skenderaj - ende nën administrimin e AKP-së
- Fabrika për prodhimin e produkteve metalike Famipa, Prizren - ka përfunduar procesin e privatizimit
- Fabrika e ngjyrave (llaçeve) Extra, Vushtrri - ka përfunduar procesin e privatizimit
- Fabrika e poliestërve, Podujevë - është në procesin e privatizimit, shitja është finalizuar

- Fabrika për prodhimin e baterive nikel-kadmium, Gjilan - ka përfunduar procesin e privatizimit
- Industria metalike, Metaliku, Gjakovë - ende nën administrimin e AKP-së me masë të përkohshme për shkak të pretendimeve të të ashtuquajturve 'aksioner'
- Fabrika për bateritë industriale, Pejë - ka përfunduar procesin e privatizimit.

16. Gjatë viteve 1980 dhe në periudhat mëhershme, minierat e plumbit dhe zinkut si dhe mineralet e tjera u prodhuan në një numër të madh minierash, por gjatë luftës së viteve 1998-99, aktivitetet e minierave u ndaluan dhe minierat u përmytën shpejt. Nga 15 minierat aktive në Kosovë, vetëm katër prej tyre (Stantërg, Artanë, Belo Bërdo dhe Cërnac, të listuara në Paragrafin 11) janë aktualisht në funksion. Këto katër përbëjnë rreth 50% të rezervave gjeologjike të të gjitha 15 minierave (FS, f.143). Rezervat gjeologjike të vlerësuara të minierave të Kosovës arrijnë në rreth 62 milionë ton, megjithëse këto vlerësime janë të vjetra.

Trepça gjatë periudhës së kontrollit nga Serbia (mars 1989-qershor 1990)

17. Nga 1989 deri në largimin e trupave dhe zyrtarëve serbë nga Kosova në qershor 1999, Trepça ishte nën sundimin e drejtpërdrejtë të qeverisë serbe dhe menaxherëve të emëruar nga ta. Kjo periudhë karakterizohet nga keqmenaxhimi, paaftësia (jo-kompetenca) dhe korrupsioni. Kompania u përball me kushtet e përkeqësuar me rënie të prodhimit, mungesën e investimeve, paisjet e pamirëmbajtura, rritjen e borxhit, mungesën e inuteve për njësitë e përpunimit dhe një cikël vicioz në rënie. Menaxhmenti u përpoq të maksimizojë prodhimin (me qëllim të fitimit nga këmbimi valutor i valutave të huaja dhe ofrimit të inuteve për industrinë metalurgjike dhe kimike) me investime minimale - një politikë destruktive me efekt negativ afatgjatë në Trepçë.

- 18.** Që nga viti 1989 prodhimi i minierave, flotacioneve dhe shkrirësëve ra në mënyrë dramatike, duke arritur pikën më të ulët në vitin 1994, duke e çuar kompaninë pothuajse në një ndalesë (prodhimi i këtyre aktiviteteve në vitin 1994 ishte rreth 5% nga nivelet e vitit 1988). Shtojca 2 jep të dhëna për ndryshimet afatgjata në prodhimin e njësive të minierave dhe flotacioneve dhe prodhimin e koncentrateve të plumbit dhe zinkut nga 1979 në 2000.
- 19.** Siç tregon edhe Shtojca 2, prodhimi i përgjithshëm i xeherorit të plumbit dhe zinkut nga tre zonat e minierave të Trepçës kishte rënë që nga fillimi i vitit 1980 (tre zonat minerare arritën maksimumin e tyre në vite të ndryshme, por totali filloi të binte në vitin 1980). Njësitë e flotacioneve ku prodhohej koncentrat i plumbit dhe zinkut, tashmë kishin arritur prodhimin e tyre maksimal në 1979.
- 20.** Pas luftës së vitit 1999, gradualisht disa nga minierat dhe njësitë e flotacionit u rehabilituan dhe u përgatitën për prodhim, edhe pse në nivele shumë më të ulëta të prodhimit se më parë. Katër minierat kryesore të Artanës, Stantërgut, Belo Bërdos dhe Cërnacit filluan të prodhojnë rreth viteve 2004/2005. Shtojca 3 tregon nivelin e prodhimit të mineraleve dhe koncentrateve nga 2005 në 2016, duke demonstruar se niveli i prodhimit është rritur gradualisht në të gjitha njësitë e minierave dhe flotacionit edhe pse ato ende nuk i kanë arritur nivelet e tyre të vitit 1989.
- 21.** Ndërmjet viteve 1989 dhe 1990, punësimi i përgjithshëm në miniera, flotacion, metalurgji, akumulatorë dhe kimikate ra me 50% (nga 13,261 në 5,720), por ai i punonjësve shqiptarë ra me 95% (nga 9,004 në 436), përderisa numri i punonjësëve serb u rritë me rreth 30% (nga 3,742 në 4,644). Struktura e detajuar e punësimit sipas shtetësisë së punonjësve në nën-njësitë kryesore të Trepçës në këtë periudhë është paraqitur në Shtojcën 4. Numri i përgjithshëm i punonjësve shqiptarë të shkarkuar në të gjithë Trepçën është vlerësuar të jetë shumë më i lartë, rreth 16,000.² Kjo ishte dëshmia më e dukshme e politikave diskriminuese të zbatuara pasi qeveria serbe mori kontrollin e drejtpërdrejtë të Trepçës.

² Mikullovc et al.,(2002), "Trepça- Një rast studimor, i paraqitur në Konferencën për Privatizimin e NSH-ve dhe Reformën e Shërbimeve në Kosovë, fq.5.' Në dispozicion në: <https://www.esiweb.org/pdf/bridges/kosovo/20/6.pdf> [Qasur më 10 tetor 2019].

22. Në vitin 1991, pozicioni financiar i kompanisë ishte përkeqësuar ndjeshëm. Shkarkimi i punonjësve shqiptarë e kishte bërë të pamundur ruajtjen e niveleve të mëparshme të prodhimit pasi që nuk kishte mjaft punonjës të kualifikuar serbë për të zëvendësuar punëtorët e shkarkuar. Është e rëndësishme të theksohet se punonjësit shqiptarë ishin nga punonjës me aftësi të ulëta e deri në inxhinierë dhe menaxherë shumë të kualifikuar, duke përfshirë drejtuesit e përgjithshëm të 13 nën-njësive të Trepçës,³ pothuajse të gjithë të cilët u pushuan nga puna. Ishte e qartë se çasja e motivuar politikisht e largimit të punonjësve shqiptarë ishte zbatuar pavarësisht nga pasojat e saj ekonomike. Kompania u bë me shumë borxhe ndaj bankave, furnizuesve, punëtorëve, Kompanisë së Energjisë Elektrike dhe të tjerëve. Zgjidhja e vetme e ofruar nga menaxhmenti ishte rritja e huamarrjes dhe, më vonë, përpjekja për të ofruar pako aksionesh ndaj kreditorëve në shkëmbim të kërkesave të tyre.

23. Në vitin 1991, menaxhmenti serb i cili kishte marrë përsipër kompaninë dhe kishte larguar një pjesë të madhe të fuqisë punëtore shqiptare, filloi një riorganizim të madh të kompanisë duke kombinuar të gjitha 21 nën-njësitë (OTPA-të) në një ndërmarrje. Minierat, Metalurgjia dhe Kombinati Kimik Trepça ishte regjistruar si ndërmarrje shoqërore më 22 nëntor 1991 nga Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë (Nr. 2320/91), si "Rudarsko-Metalursko-Hemijski Kombinat RMHK Trepča". Siç u përmend më herët, ky riorganizim ishte i paligjshëm, sepse pjesa më e madhe e të punësuarve që kishin të drejtën e marrjes së vendimeve të tilla ishin pushuar nga puna dhe në këtë mënyrë ishin të privuar nga të drejtat e tyre të vetëqeverisjes të garantuara me Kushtetutën e RSFJ-së.

24. Gjithashtu në vitin 1991, Trepça përjetoi një ndryshim të madh në strukturën e saj të pronësisë. Ajo u konvertua në një Shoqëri Aksionare me 89.3% të aksioneve në pronësi shoqërore dhe pjesa tjetër u transferua në dy banka dhe 9 ndërmarrje. Nuk kishte shitje formale të aksioneve të këtyre njësive ekonomike dhe nuk kishte pasur ndonjë vlerësim formal të aksioneve. Bankat dhe shumica e këtyre ndërmarrjeve ishin kreditorë të Trepçës që konvertuan të gjitha ose disa nga pretendimet e tyre në

³ Mikullovc et al.,(2002), "Trepca- Një rast studimor, i paraqitur në Konferencën për Privatizimin e NSH-ve dhe Reformën e Shërbimeve në Kosovë, fq.6.' Në dispozicion në: <https://www.esiweb.org/pdf/bridges/kosovo/20/6.pdf> [Qasur më 10 tetor 2019].

aksione të Trepçës me një çmim nominal (efektivisht një shkëmbim borxh-kapital). Kjo u bë një metodë e zakonshme e mbledhjes së parave të gatshme për të paguar borxhet e Trepçës gjatë dekadës së ardhshme. Dy ndërmarrje të tregtisë së jashtme (Progres dhe Genex) paguan aksionet e tyre, duke injektuar disa të holla në kompani.⁴ Aneksi 5 tregon strukturën e pronësisë së Trepçës në fund të vitit 1992 dhe 1999, duke treguar se si aksionet e NSH Trepça u transferuan gradualisht në entitetet e tjera private apo publike kryesisht në Serbi.

25. Në vitin 1992, mbi 63% të aksioneve në kategorinë e ashtuquajtur 'pronësi shoqërore' u transferuan në Fondin për Zhvillimin e Serbisë. Transferimi i mëtejshëm i aksioneve për ndërmarrjet dhe bankat u zhvillua në vitet në vijim. Deri në fund të vitit 1999, rreth 70% të aksioneve ishin në duart e 3 bankave, një kompanie sigurimi dhe disa ndërmarrjeve (që kishin qenë kreditorë të Trepçës në vitet e mëparshme) dhe rreth 30% nën 'pronësinë shoqërore' (shih Shtojcën 5).

26. Në mënyrë efektive, aksionet e Trepçës u transferuan në institucionet dhe kompanitë serbe në këmbim të borxheve që rrjedhin nga keqmenaxhimi i kompanisë ose injektimi i parave të gatshme për të trajtuar problemin e likuiditetit, pagat e papaguara dhe vështirësitë e tjera financiare. Të gjitha aspektet e këtyre transfereve të aksioneve ishin të paligjshme. Serbia duhet të marrë përgjegjësinë për krijimin e këtyre borxheve dhe ndryshimin e pronësisë së një NSH në një formë tjetër pa pajtimin e punonjësve - madje as edhe të punonjësve serbë të asaj periudhe.

27. Në shkurt të vitit 1995, u emërua një Drejtor i Përgjithshëm i ri. Drejtori i ri, Novak Bjelić, i cili ishte pronar i shumë ndërmarrjeve private në Jugosllavi, duke përfshirë FAGAR, më vonë FAN (në Podujevë) dhe kompani të tjera në Serbi, hyri me kompanitë e tij private në transaksione biznesi me Trepçën, duke ndihmuar kështu në kalimin e pasurive të Trepçës në duart private. Bjelić, i cili ishte anëtar i Asamblesë Federale, një aktivist i partisë dhe i afërt me Millosheviqin, mbeti në pushtet deri në rënien e Millosheviqit. Ai u shkarkua në janar të vitit 2001 nga Bordi

⁴ Palairt, M. (2003), 'Trepca, 1965-2000, fq.23.' Në dispozicion në: https://www.esiweb.org/pdf/esi_document_id_62.pdf [Qasur më 12 tetor, 2019].

Drejtues i Trepçës. Kundër tij dhe dy zyrtarëve të Trepçës janë ngritur kallëzime penale për shpërdorim të pozitës zyrtare dhe nënshkrimin të kontratave që dëmtojnë Trepçën.⁵

28. Gjatë mbretërimit të Bjelić, pozita e Trepçës u përkeqësua edhe më tej; mineralet dhe metalet iu shiteshin blerësve para se të prodhoheshin; blerësit e huaj të mineraleve dhe metaleve u inkurajuan që të japin kredi për kompaninë kundrejt ofrimit të ardhshëm të metaleve; mosmarrëveshjet në punë dhe grevat e shumta kishin rezultuar në reduktim të mëtejshëm të prodhimit dhe dështimit për të përmbushur afatet, duke krijuar më shumë borxhe. Më vonë, disa nga kreditë u konvertuan në aksione; disa aksione u shiteshin bankave dhe subjekteve të tjera për të mbledhur para për kompaninë që varej nga keshi. Gjithashtu, janë parashtruar shumë kërkesa kundër Trepçës nga bankat, bizneset e huaja, furnizuesit, punonjësit etj. Pjesa më e madhe e këtyre kërkesave janë paraqitur nga dy kompani të huaja, Mytileneous Co. nga Greqia dhe SCMM Co. nga Franca, të dyja me lidhje të ngushta me Bjelić dhe kompanitë e tij private (për një diskutim të detajuar të marrëveshjeve midis këtyre kompanive, Trepça dhe Bjelić, shih Palairret, 2003).

29. Një nga veprimet ilegale të Bjelić, me pasoja serioze për punonjësit, ishte anashkimi i rregulloreve që kërkonin nga kompanitë të paguanin taksat, pensionet dhe kontributet shëndetësore nëpërmjet sistemit bankar. Bjelić kishte rregulluar pagimin e rrogave neto për punonjësit nëpërmjet bankës së kursimit postar, duke shmangur kështu zbritjet automatike të taksave dhe kontributeve të punonjësve dhe duke privuar shumë punonjës (kryesisht serbë) pagesën e pensioneve të tyre (për detaje shiko Palairret, 2003, përmbledhje, fq.5). Shmangia totale e taksave dhe kontributeve arriti në 11.6 mil. € deri në fund të vitit 2000. Ky veprim ishte i njohur për të gjithë, duke përfshirë autoritetet tatimore në Serbi, por lidhjet politike të Bjelić siguruan që mos të ndërmerrej asnjë veprim për të ndaluar këtë praktikë.

30. Në vitin 2001, Trepça kishte një borxh zyrtar total prej 76.7 mil. € për autoritetet tatimore (për taksat dhe kontributet e papaguara të punonjësve të përmendur në

⁵ Palairret, M. (2003), 'Trepça, 1965-2000, fq.86.' Në dispozicion në: https://www.esiweb.org/pdf/esi_document_id_62.pdf [Qasur më 12 tetor 2019].

paragrafin e mësipërm), furnizuesit, bankat dhe disa kreditorë që kishin paditur me sukses shoqërinë. Megjithatë, kjo është vetëm një pjesë e detyrimeve totale të kompanisë. Në të njëjtin vit, janë paraqitur 113 padi nga kreditorët kundër Trepçës për një shumë totale prej 84.2 mil. € (dy parashtues të huaj të përmendur në paragrafin e mëparshëm). Shtojca 6 paraqet një shpjegim të hollësishëm të borxheve të bilancit të gjendjes dhe të padive jashtë bilancit të paraqitura kundër kompanisë në vitin 2001.⁶

31.Dëmet mjedisore në Kosovë ishin gjithashtu të mëdha (dhe vazhdojnë ende përkundër UNMIK-ut dhe më vonë Qeverisë së Kosovës që janë munduar të përmirësojnë shembujt më të këqij). UNMIK-u dhe KFOR-i vendosën që të mbyllin shkretoren në Zveçan për arsye të ndotjes së tepërt dhe rrezikimit të shëndetit të qytetarëve. Mungesa e vëmendjes ndaj kostove mjedisore gjatë viteve 1990 rezultoi me dëmtime të mëdha të burimeve të ujit dhe tokës rreth flotacionit të Trepçës, njësive kimike dhe metalurgjike. Gjatë menaxhimit të Trepçës në vitet 1990, menaxhmenti serb pothuajse tërësisht e injoroi dëmin mjedisor dhe nuk ndërmori asnjë veprim të rëndësishëm për të zbutur ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës. Ky është një tjetër aspekt ku Serbia duhet të pranojë përgjegjësinë për dëmtimin e mjedisit në Kosovë.

32.Trepça kishte gjithashtu një sasi të konsiderueshme asetesh jashtë Kosovës, në miniera, si dhe në sektorë të tjerë (përfshirë një fermë në Vojvodinë). Gjatë periudhës 1996-2000, rreth 25% e listës së pagave të përgjithshme të Trepçës u ishte paguar punonjësve në njësitë e ndryshme të Trepçës të vendosur në Serbi.⁷

Trepça nën UNMIK-un dhe Kosovën e Pavarur

33.UNMIK-u mori kontrollin e kompanisë në qershor të vitit 1999 pas largimit të trupave dhe zyrtarëve serbë nga Kosova. Menaxhmenti i Trepçës u transferua në

⁶ Palairt, M. (2003), "Trepça, 1965-2000, fq.88." Në dispozicion në: https://www.esiweb.org/pdf/esi_document_id_62.pdf [Qasur më 12 tetor 2019].

⁷ Përveç veprimtarive në Serbi, që zënë rreth një të katërtën e listës së pagave të përgjithshme, Trepça gjithashtu kishte pasuri në Mal të Zi dhe Vojvodinë (Palairt, 2003, përmbledhje, f.2).

Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) pasi u krijua në vitin 2002 dhe më vonë Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) pas shpalljes së pavarësisë në vitin 2008. Kohët e fundit kompania është riorganizuar në bazë të Ligjit të vitit 2016 për Trepçën. Tani është nën menaxhimin e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik e cila ushtron të drejtat e aksioneve të qeverisë prej 80%.

